

---

*Treguesit për caktimin e normës në % të KUNC*

---

Në përputhje me rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” miratuar me vendimin nr.41, datë 05.06.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe udhëzimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik, për përcaktimin e normës së shtesës kundërciklike të kapitalit përdoren treguesit e referencës. Këta tregues synojnë të reflektojnë në mënyrë sa më të drejtë ciklin e kreditimit dhe rreziqet që shoqërojnë rritjen e tepërt të kreditimit në vend, si edhe të konsiderojnë në mënyrë të përshtatshme specifikat e ekonomisë së vendit. Vlerat sasiore të treguesve janë gjithmonë subjekt i interpretimit dhe analizës së ekspertëve të cilët në analizë mund të përfshijnë edhe faktorë të tjerë cilësorë.

Midis treguesve të referencës, si parësor shërben “hendeku i raportit të kredisë për ekonominë ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)”, që paraqet devijimin e vlerës aktuale të raportit “kredi për ekonominë / PBB” nga prirja e tij afatgjatë. Ky tregues sinjalizon mundësinë e rritjes së tepërt të kreditimit në raport me rritjen ekonomike dhe eventualisht rritjen e rreziqeve sistemike ciklike. Si plotësues të treguesit parësor, shërbejnë disa të tjerë të grupuar tek treguesi i paralajmërimit të hershëm (TPHP). Krahas treguesit parësor, ky përbëhet edhe nga pesë nëntregues të tjerë, që sinjalizojnë zhvillimet në kreditim dhe në aktivet jofinanciare (tregu i pasurive të paluajtshme).

---

*Arsyetimi mbi caktimin e normës në % të KUNC*

---

Tabelat në vijim paraqesin vlerat më të fundit të disponueshme të treguesve të përzgjedhur dhe mesataret historike përkatëse.

*Tabelë 1: Treguesi parësor*

Treguesi	Mesatarja historike		T1 2019
	T4 2002-T4 2008	T1 2009-T4 2018	
<i>Hendeku i kredisë për ekonominë ndaj PBB-së<sup>1</sup></i>	1.9%	-7.1%	-11.1%

*Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.*

---

<sup>1</sup> Vlera e PBB-së është llogaritur si shuma e vlerave të katër tremujorëve të fundit.

*Tabelë 2: Treguesit e tjerë<sup>2</sup>*

<b>Treguesi</b>	<b>Mesatarja historike (T4 2002-T4 2018)</b>	<b>T1 2019</b>
Intensiteti i kredisë për ekonominë <sup>3</sup>	3.2%	-0.3%
Rritja vjetore e kredisë bankare për pasuri të paluajtshme	23.7%	-1.1%
Rritja vjetore e indeksit të “çmim i banesave / vlera e qirasë”	8.1	-0.1
Rritja vjetore e indeksit real të çmimit të banesave	3.8	-2.2
Rritja vjetore reale e kredisë bankare <sup>4</sup>	17.7%	-4.1%

*Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT.*

Vlerat e treguesve dhe gjykimi i ekspertëve, tregojnë se ecuria e kredisë mbetet e dobët dhe sugjerojnë se rreziqet që lidhen me kreditimin e tepërt nuk janë aktualisht të rëndësishëm. Si rezultat norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë, propozohet të jetë 0%.

<sup>2</sup> Këta tregues, së bashku me treguesin parësor, përbëjnë “Treguesi i Paralajmërimit të Hershëm Plotësues”.

<sup>3</sup> Rritja vjetore e kredisë për ekonominë si raport ndaj vlerës së vjetorizuar të PBB-së (shuma e vlerave të PBB-së për katër tremujorët e fundit).

<sup>4</sup> I referohet kredisë së dhënë nga sektori bankar për sektorin privat rezident.